



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 5

Tiranë – E hënë, 12 shkurt 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nr. 1044, datë 31.1.2024	Për emërimin e z. Ervis Vata si nëpunës civil në pozicionin Specialist në Sektorin e Lejeve Mjedisore në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër..... 3
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 423, datë 9.2.2024	Për rishpalljen 1 (një) vendi vakant për pozicionin e Këshilltarit Ligjor, me afat të caktuar, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.... 3



NJOFTIM

Nr. 1044, datë 31.1.2024

**PËR EMËRIMIN E Z. ERVIS VATA SI
NËPUNËS CIVIL NË POZICIONIN
SPECIALIST NË SEKTORIN E LEJEVE
MJEDISORE NË AGJENCINË
RAJONALE TË MJEDISIT
TIRANË/DURRËS/DIBËR**

Në vijim të shkresës së Departamentit të Administratës Publike me nr. 6313/4 prot., datë 17.1.2024, me lëndë “Kërkesë për ndihmë administrative”, ku kërkohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit njoftimi i aktit nr. 6313/2 prot., datë 10.1.2024, për emërimin e z. Ervis Vata në pozicionin Specialist në Sektorin e Lejeve Mjedisore në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër, kategoria e pagës IV-b.

Bazuar në nenin 66/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, urdhrin nr. 5151/2015, “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit “Për shërbimin civil”, në vijim të propozimit të Komisionit të Posaqëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përcjellë me akt-rekomandimin nr. 39 prot., datë 3.1.2024, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 468, datë 29.9.2021, e cila ka ndryshuar vendimin nr. 1632, datë 30.4.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë,

z. Ervis Vata

emërohet nëpunës civil në pozicionin Specialist në Sektorin e Lejeve Mjedisore në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër, kategoria e pagës IV-b.

Ndaj këtij akti mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

**DREJTOR DEPARTAMENTI
Enkela Dudushi**

NJOFTIM

Nr. 423, datë 9.2.2024

**PËR RISHPALLJEN 1 (NJË) VENDI
VAKANT PËR POZICIONIN E
KËSHILLTARIT LIGJOR, ME AFAT TË
CAKTUAR, NË KOMISIONIN E
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rishpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit ligjor, me afat të caktuar, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;



3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (originale ose të noterizuara));
4. Dëshmi penaliteti;
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen **brenda datës 25 shkurt 2024** pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2024